

**Njoftim për përqendrimin me të cilin 4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo
Reszvenitarsasag, Hungari do të fitojë kontroll mbi Raba Jarmuipari Holding Nirt.,
Hungari
(lënda nr. 08-147/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 06.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin, 4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag me seli të regjistruar në rrugën Krisztina körut nr. 39, 1013 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll mbi Raba Jarmuipari Holding Nirt., shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rrugën Martin nr. 1, 9027 Gjer, Hungari.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

4iG SDT EGJI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag është shoqëri aksionare, veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e kompanive holding, telekomunikacioni dhe integrimi i sistemeve IT, teknologjitë e gjithësisë dhe mbrojtjes, shërbimet radiodifuzive dhe satelitore.

4iG SDT EGI Zartkoruen Mukodo Reszvenitarsasag ka një person juridik të lidhur në Maqedoninë e Veriut, dhe ai është Shoqëria për shërbime të komunikimit ONE MAKEDONIJA TELEKOMUNIKACII SHPKNJP Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në pajtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me NUAS: 7804148 dhe seli në rrugën Crvena Voda numër 7/3, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria prioritare e së cilës është 61.20 – veprimtari të telekomunikimeve pa tela.

Raba Jarmuipari Holding Nirt. (Rába Járműipari Holding Nyrt.) është shoqëri aksionare me veprimtari afariste nga fusha e industrisë automobilistike, me veprimtari kryesore si shoqëri holding me më shumë njësi afariste që veprojnë në fushën e industrisë automobilistike, gjegjësisht industria për prodhimin e automjeteve të ndryshme dhe pjesëve të tyre. Raba Jarmuipari Holding Nirt. nuk ka persona të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që si treg relevant të merret tregu i përgjithshëm për prodhimin dhe shitjen e pjesëve për automjete motorike për të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të hetimit preliminar, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

08.10.2025
Shkup